



**UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

---

Rektori: Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

Ref. nr.01/ 1039 14 /06 /2019

---

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212, dispozitat e nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës, Nr. 04/L-037, si dhe nenit 48, paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, Senati i Universitetit në mbledhjen XXXI, të mbajtur më datë 06.06.2019, merr vendim për të shpallur:

## **K O N K U R S**

**Për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të Universitetit "Kadri Zeka" Gjilan, për vitin akademik 2019/2020.**

### **Fakulteti i Edukimit**

1. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë angleze I dhe II, Gjuhë angleze për mësues me plotësim norme në Fakultetin Juridik në lëndët Gjuhë Angleze I dhe II.

### **Fakulteti Ekonomik**

2. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Qeverisje korporative, Menaxhimi i riskut dhe sigurimit.
3. Një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Bankat dhe afarizmi bankar, Financat korporative, analiza e investimeve, Menaxhmenti bankar.
4. Një mësimdhënës për lëndët: Financa, Financa nderkombetare, Menaxhimi i investimeve, Auditimi, Ekonomia e Kosoves dhe BE-se, Teoria dhe politika monetare.

### **Fakulteti Juridik**

5. Një mësimdhënës për grup lëndësh nga fusha: juridike – penale.

### **Fakulteti i Shkencave Kompjuterike**

6. Një mësimdhënës për lëndët: Matematikë për informatikë I dhe II me plotësim norme në Fakultetin e Edukimit në lëndët: Metodologji e mësimit të matematikës I në programet Fillor dhe Parashkollor.

## **Kandidatët të cilët paraqiten në konkurs duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:**

- Kërkesën;
- Biografinë (CV) ;
- Kopjen e diplomës të studimeve themelore, masterit dhe doktoraturës, të noterizuara;
- Certifikatën e notave në tri nivelet e studimit;
- Certifikatën e lindjes;
- Certifikatën e shtetësisë (ose certifikatën për vendbanimin në Republikën e Kosovës) ;
- Dëshmi (kopjet) për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj.
- Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie dhe profesione tjera lidhur me fushën e mësimdhënies në arsimin e lartë;
- Çertifikatë nga gjykata, se ndaj tij nuk janë duke u zhvilluar hetime;
- Dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet baçelor apo master jashtë vendit duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i .

Kandidatët duhet të sjellin njërin prej këtyre dokumenteve si dëshmi për njohjen e gjuhës së huaj botërore:

1. Të kenë të kryer njërin nivel të studimeve në gjuhën e huaj ose certifikatë IELTS, TOEFL apo ndonjë dokument tjetër të vlefshëm.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet e parapara me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr.04/L-037, Statutin e Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka” Gjilan, në veçanti ato që parashihen në nenin 155,156 dhe157 të këtij Statuti (shih: <http://uni-gjilan.net/dokumente-relevante/> ) dhe Rregulloreve në fuqi për zgjedhjen e personelit akademik në UKZ.

### **Konkursi mbetet i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në gazetë.**

Paraqitja e dokumenteve: Kërkesa protokolohehet në zyrën nr.4, kurse i tërë dokumentacioni dorëzohet në zyrën për çështje akademike, nr. 3.

**Aplikantët duhet të plotësojnë formularin P1 të cilin mund t'a shkarkojnë nga ueb- faqja e universitetit, dhe në mënyrë elektronike e dërgojnë në [info@uni-gjilan.net](mailto:info@uni-gjilan.net) kurse dokumentet e tjera dërgohen në kopje fizike.**

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim. Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në ueb faqen zyrtare të universitetit: <http://www.uni-gjilan.net>